



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL

**PLK. D. nr. 50/24**

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT**, i përbërë nga Valdete Daka, kryesuese e Panelit, Burim Ademi dhe Argjira Asllani, anëtar të panelit, me pjesëmarrjen e Mersime Mehmeti, u.d. koordinatorë të panelit për lirim me kusht, duke vendosur përkitazi me kërkesën për lirim me kusht, të parashtruar nga i dënuari G. K., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 22 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 500€, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.73/2022, i datës 06.04.2022, pas shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117 dhe 118 par. 4 të Ligjit N. 08/ L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenet 9, 10, 11, 15, 17, 20 par. 1 dhe par. 2 pika 2.2, 21 dhe nenin 28 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht, në seancën e mbajtur me datë 20.02.2024, në selinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET** kërkesa për lirimin me kusht e të dënuarit G. K. nga i aty S. dhe e ëma S., e gjinisë H., i lindur me ..., M., ku edhe e ka vendbanimin në rr. "...", me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**II.** Kërkesa për lirimin me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 3 muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.73/2022, i datës 06.04.2022, G. K. është shpall fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 22 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 500€.

Me datë 25.01.2024, i dënuari përmes Institucionit Korrektues ku është në mbajtje të dënimit me burg, ka parashtruar kërkesë për lirim me kusht me arsyetimin se gjatë mbajtjes së dënimit, me

sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirimin e tij me kusht.

Në seancën e mbajtur me datë 20.02.2024, Paneli pasi e shqyrtoi dosjen e të dënuarit, përkatësisht raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Institucionit Korrektues, Deklaratë-premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit Nr. 08/L-132 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenin 15 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes gjeti se:

Kërkesa për lirim me kusht është e **pabazuar**.

Nga shkresat e dosjes së të dënuarit, rezulton se i njëjti është shpallur fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së.

Në raportin ligjor për të dënuarin vërtetohet se data e përfundimit të dënimit është caktuar më 27.05.2024 dhe nga llogaritja e dënimit rezulton se i dënuari deri më tani i ka mbajtur 18 muaj, 23 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 3 muaj, 7 ditë.

Në raportet e tjera të përpiluara nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, rezulton se i dënuari ka rënë ndesh me rregullat e Institucionit Korrektues, përkatësisht nga shqyrtimi paraprak i kërkesës për lirim me kusht, ka të dhëna për shkelje të reja disiplinore, me datë 29.01.2024, i është shqiptuar masa disiplinore, qortim.

Gjatë shqyrtimit të dosjes së të dënuarit, Paneli vlerësoj plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe rrethanat e tjera që ndikojnë në lirimin me kusht të personit të dënuar që parashihen në nenin 11 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht. Rrethanat përfshijnë: përshkrimin e personit të dënuar për veprën penale, gjendjen fizike dhe psikike të tij, qëndrimin e personit të dënuar ndaj viktimës, sjelljen e mirë gjatë burgimit, përkatësisht të dhënat nëse është shqiptuar masë disiplinore ndaj tij gjatë vuajtjes së dënimit, rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore, planet e të dënuarit pas lirimit, pranimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ShSK, ekzistenca e një rreziku të përgjithshëm për shoqërinë/komunitetin, programet rehabilituese të ndjekura nga personi i dënuar, vlerësimin e progresit të arritur te i dënuari në planin individual të rehabilitimit dhe rrethanat e tjera të vlerësuara nga paneli që tregojnë se i njëjti nuk do të kryej veprë penale.

Paneli pas shqyrtimit të dosjes, vlerësimit të kushteve dhe rrethanave si më lartë, konstatoi se nuk është arritur risocializimi i plotë te i dënuari për shkak se në të dhënat mbi shkeljet disiplinore, rezulton se i dënuari ka rënë ndesh me rendin dhe rregullat e Institucionit Korrektues, si dhe ekzistimi i rrezikut për recidivizëm. Mbi bazën e këtyre konstatimeve, Paneli ka ardhur në përfundim se ende nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal i paraparë sipas dispozitës së nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua për periudhën kohore prej 3 muaj dhe mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Nga sa u tha më lartë, në zbatim të nenit 20 par. 2 pika 2.2 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT**  
**PLK. D. nr. 50/24, datë 20.02.2024**

U.d. Koordinatore e Panelit

Mersime Mehmeti

Kryesuese e Panelit

Valdete Daka

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqitet ankesë drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të vendimit.